



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK SKRAPAR



Nr. 28 Prot.

Skrapar më 13 / 06 /2023

Lënda: NJOFTIM PËR ZHVILLIMIN E MBLEDHJES SË KONSTITUIMIT TE

KËSHILLIT TË BASHKISË SKRAPAR

I Nderuar Këshilltar i mandatuar nga KQZ

Në zbatim të Ligjit Nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" Neni 2, pika 5, "Kompetencë", Neni 48 pika 2, pika 6, germa a, b, c, ç, d, Neni 60, pika 3, ditën e premte më datë 16.06.2023 ora 11⁰⁰, në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Bashkisë Skrapar, Qendra Kulturore "Riza Cerova" kati i dytë, do të zhvillohet mbledhja e konstituimit të Këshillit Bashkiak Skrapar, zgjedhja e organeve drejtuese e përfaqësuese, deklarimi i vlefshmërisë së Mandatit të Kryetarit të Bashkisë të dalë nga zgjedhjet vendore të datës 14. 05. 2023, me këtë rend dite:

1. Konstituimi i Këshillit Bashkiak
 - a. Zgjedhja e Komisionit të Vërtetimit të Mandateve (3 anëtarë)
 - b. Verifikimi dhe miratimi i mandateve të anëtarëve të këshillit bashkiak.
 - c. Betimi i Këshilltarëve sipas formulë së betimit të parashikuar në nenin 50 të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" dhe nënshkrimi i aktit të betimit.
2. Zgjedhja e Kryetarit të Këshillit të Bashkisë.
 - a. Propozimi i kandidatëve nga grupet e këshilltarëve (Prezantim i shkurtër i kandidatëve)
 - b. Ngritja e komisionit të votimit (3 anëtarë)
 - c. Përgatitja e fletëve të votimit, procedurave, realizimi i votimit të fshehtë.
 - d. Shpallja e rezultatit të votimit dhe kalimi i drejtimit të mbledhjes tek Kryetari i Këshillit sapozgjedhur.





3. Zgjedhja e Zëvendëskryetarit të Këshillit të Bashkisë.
 - a. Miratimi me votim të hapur i numrit të nënkryetarëve të Këshillit
 - b. Propozimi i kandidatëve për zëvendëskryetarë, duke respektuar ligjin për barazinë gjinore.
 - c. Përgatitja e procedurave të votimit, kryerja e votimit
 - d. Shpallja e rezultateve të votimit

4. Zgjedhja e këshilltarit që do të përfaqësojnë Këshillin e Bashkisë Skrapar në Këshillin e Qarkut.
 - a. Leximi i shkresës së Prefektit për numrin e përfaqësuesve të Këshillit të Bashkisë në Këshillin e Qarkut
 - b. Paraqitja e propozimeve nga grupet e Këshilltarëve
 - c. Përgatitja e procedurave të votimit, kryerja e votimit.
 - d. Shpallja e rezultatit

5. Ceremonia e marrjes në dorzim të detyrës së Kryetarit të Bashkisë.
 - a. Deklarimi i vlefshmërisë së Mandatit të Kryetarit të Bashkisë.(Leximi i vendimit të Gjykatës për vlefshmërinë e mandatit)
 - b. Betimi i Kryetarit dhe nënshkrimi i aktit të betimit.
 - c. Fjala përshëndetëse e kryetarit Bashkisë

6. Mbyllja e mbledhjes

SEKRETARE E KËSHILLIT BASHKIAK

HAVA NUELLARI

